



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:283188  
Datë: 25.03.2024  
Numri i dokumentit: 05500347

C.nr.2072/22

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Fëllanza Knushaj dhe me bashkëpunëtoren profesionale Argjelina Prenku, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit A.SH., nga fshati ... Komuna e Gjakovës, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj, që të dy avokatë në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilin me autorizim e përfaqëson e autorizuara V.Rr., me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 1,760.98 euro, jashtë seance me datë 25.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.SH., nga Komuna e Gjakovës dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit të lartcekur, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit për periudhën kohore nga 01.09.2022 e deri me datë 30.11.2022, të ia paguajë shumën e përgjithshme prej 146.51.-€ (njëqind e katër dhjetë e gjashtë euro e pesëdhjetë e një cent) me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data 23.12.2022 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

II. REFUZHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit mbi shumën e aprovuar sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar dhe atë në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit, në shumën prej 1.614.47.-€.

III. KONSTATOHET e tërhequr padia e paditësit A.SH., nga Komuna e Gjakovës ndaj të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, në lidhje me kërkesën për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore prej datës 01.01.2018 deri me datë 31.12.2019.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit të ia paguaj shumën prej 228.00.-€ (dyqind e njëzet e tetë euro) në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

Paditësi A.SH., nga fshati ....., Komuna e Gjakovës, në këtë gjykatë me datë 23.12.2022, përmes të autorizuarve të tij Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj, që të dy avokatë në Prishtinë, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësi është punëtor i arsimit në shkollën “..” në Gjakovë. Në bazë të nenit 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e paditura ka për obligim që për çdo vit të përcjellë shkallën e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë të paditësit. Meqë e paditura nuk e ka përmbytur këtë detyrim, paditësja ka paraqitur padi përmes të cilës ka kërkuar që të i kompensohet diferenca e inflacionit në pagë, me kamatë ligjore si dhe i ka kërkuar edhe shpenzimet procedurale. I autorizuari i paditësit, av. Arben Biblekaj, fillimisht me parashtrësën e datës 20.10.2023, ka bërë tërheqjen e padisë sa i përket periudhës nga data 01.01.2018 deri me datë 31.12.2019, si dhe ka bërë zgjerimin e kërkesëpadisë sa i përket muajve Tetor dhe Nëntor 2022. Po ashtu i njëjti me parashtrësën e datës 14.11.2023, ka bërë zgjerimin e kërkesëpadisë në aspektin objektiv, ashtu që ka kërkuar nga gjykata që ta detyroi të paditurën që në emër të kompensimit të diferencës së inflacionit në pagë nga data 01.01.2020 deri me datë 21.11.2022 paditësit të ia paguajë shumën prej 1,760.98 euro, e ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale. Parashtrësat e sipërcituara, i janë dorëzuar me kohë të paditurës, mirëpo e njëjta nuk është përgjigjur lidhur me të.

E paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj V.RR., në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 06.10.2023, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se ky kompensim paditësit nuk i takon as me kontratën e punës, e gjithashtu as me Ligjin e Punës. Sa i përket Kontratës Kolektive ka konsideruar se e njëjta është në kundërshtim me Ligjin e Punës, pasi që Komuna e Gjakovës nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve. Tutje ka shtuar se paditësit nuk i takon e drejta e kompensimit të inflacionit pasi që në rast të shfaqjes së tij nuk godet vetëm një sektor të punësuarve si në rastin konkret sektorin e arsimit, por e godet tërë aparatit shtetëror. Ka konsideruar se në rastin konkret ka po ashtu parashkrim të kërkesës në të holla, andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesë padinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, precizim të padisë dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësin e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “...” në .., Komuna e Gjakovës, si mësimdhënës i mësimit klasor Bazuar në

Listën e pagës të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit për periudhën 01.11.2022 deri me 30.11.2022 ka qenë në shumën prej 421.00 euro. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Provave të lartcekura gjykata iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të ciline ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021 e cila ka qenë në fuqi deri me datë 21.11.2022, ku në mënyrë identike në nenin 35 par.10 kanë përcaktuar se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga listat e pagave që gjenden në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, përkatësisht ngritjes për vitin 2022 (*brenda kërkesës së paditësit*) sipas përlllogaritjes si në vijim:

Për periudhën Shtator-Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, andaj duke e llogaritur në pagën bazë të paditësit e cila në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 3 mujore në total të jetë 146.51 euro, apo 48.84 euro për muaj ( $421.00 * 11.6\% * 3 = 146.51$ ).

Duke qenë se mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike përkatësisht se paditësi është i punësuar tek e paditura dhe se në periudhën nga data 01.09.2022 deri me datë 21.11.2022 në pagën e paditësit nuk është përfshirë edhe shkalla e caktuar e inflacionit, të cilat fakte nuk i ka kontestuar as e paditura në përgjigjen në padi, edhe përkundër faktit se e njëjta e ka kundërshtuar kërkesëpadinë, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të ciline pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit mbi bazën e inflacionit, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila bazohet në Ligjin nr.03/L-212 të Punës. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësit dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësen.

Pretendimin tjetër të të paditurës lidhur me atë se inflacioni godet tërë aparatit shtetëror e jo vetëm sektorin e arsimit, gjykata e konsideron si të parëndësishëm, për arsye se çështja e përfshirjes së inflacionit në pagën e punëtorëve të arsimit është e rregulluar me KKAK, andaj është irelevante se kushte goditet nga inflacioni, për aq kohë sa e drejta e paditësit për ta kërkuar këtë kriter të kompensimit rrjedh nga dispozitat e kontratës kolektive të lartcekur.

Sa i përket pretendimit të dhënë në përgjigje në padi se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës, gjykata vë në dukje se i autorizuari i paditësit me parashtresën e datës 20.10.2023 ka bërë tërheqjen e padisë sa i përket pjesës së parashkruar, përkatësisht për periudhën nga data 01.01.2018 deri me datë 31.12.2019, ndërsa pretendimi se kërkesa është e parashkruar në tërësi rezulton i pabazuar sa i përket periudhës prej datës 01.01.2020 e deri me datë 21.11.2022 pasi që konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret duke pasur parasysh se padia është paraqitur me datë 23.12.2022, rezulton se për periudhën e lartcekur, padia është paraqitur brenda afatit prej tre viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Sa i përket pjesës refuzuese respektivisht shumës në lartësi prej 1,614.47 euro gjykata të njëjtën e refuzoi për shkak se paditësi as me padi, as në precizimin e padisë nuk ka prezantuar prova materiale për të vërtetuar këtë lartësi të kërkesës, sipas detyrimit të përcaktuar me nenin 7 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) ku është paraparë se *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. E për më tepër, gjykata përlllogaritjen e përfshirjes së inflacionit në pagën bazë për vitin 2022, për çka rezultoi se pjesa e kërkesëpadisë përtej shumës së aprovuar është e pabazuar, andaj gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e*

*pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadija qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*

Po ashtu pjesa refuzuese i referohet edhe kërkesës së paditësit që të kompensohet pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit edhe për periudhën prej 01.01.2020 deri me 31.08.2022 pasi që nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës përkatësisht kontrata e punës për paditësin rezulton se i njëjti punën tek e paditura e ka filluar me datë 01.09.2022, për çka gjykata nuk ia njohi këtë kompensim paditësit për periudhën e lartcekur. Për më tepër i njëjti nuk ka sjellë listë të pagave për periudhën e mëparshme, atë para vitit 2022.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, meqenëse i autorizuari i paditësit me parashtresën mbi precizimin e kërkesëpadijës të datës 20.10.2023 ka tërhequr padinë për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën nga data 01.01.2018 deri me datë 31.12.2019, andaj gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 261 par.2 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën IV të dispozitivit, gjykata e morri sipas nenit 449 dhe 452 të LPK-së, duke pasur parasysh suksesin në procedurë, me ç’rast paditësit iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 228.00.€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00.-€ (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 104.00.-€, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17), si dhe për përpilimin e parashtresës për precizimin e padisë shumë prej 104.00.-€.

Nga të lartcekurat, gjykata bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

-Departamenti i Përgjithshëm-

C.nr.2072/22, datë 25.03.2024

Gj y q t a r j a,  
Fëllanza Knushaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.